



Në bazë të nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-139,për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205,dhe Nenit 97 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën administrative,të Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit, komentimit dhe intervistimit të palëve, brenda afatit ligjor, Kryetari i Komunës së Gjakovës, Z.Ardian Gjini, mori këtë :

VENDIM PRELIMINAR MBI LIGJSHMËRINË E SHPRONËSIMIT TË PROPOZUAR

1.APROVOHET kërkesa e subjektit kërkuar, Komunës së Gjakovës, për shpronësim të pronarëve të pronave të paluajtshme dhe zotëruesve të interesit, të cilat ndodhen në zonën kadastrale të Komunës së Gjakovës, Z.K.Gjakovë-j.qytet. Qëllimi për të cilin shpronësohen ka të bëjë me vazhdimin e ndërtimit të rrugës “Bujar Roka” në Gjakovë, për parcelën nr.5531/27,(pjesë e saj) sipas tabelës së bashkangjitur me këtë vendim.

2. Pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës, njoftohen pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen që brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit i njëjti do të shpallet në gazetën zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

3.Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda (30) tridhjetë ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkuar dhe cili do person i cili është pronarë ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjakovës.

5.Vendimi hyn në fuqi me datën e shpalljes së tij në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit;
- Shërbimi profesional të Kuvendit të Komunës;
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Drejtorisë për Shërbime Publike;
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronë;
- Arkivit.

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SKUPSTINA OPSTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Vazhdimi i Rrugës "Bujar Roka"							
Nr. Rend or	Numri parcelës	Pronari	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme [m ²]	Sipërfaqja për shpronësim [m ²]	Sipërfaqja e mbetur[m ²]	Zona Kadastrale
1	5486-1	1/3 Rexhaj Mehmet (Sadri)	Are(1), Shtëpi-ndertese	79590	738	78852	Gjakove Jashte Qytet
		1/3 Rexhaj Murat (Sadri)					
		1/3 Rexhaj Islam (Sadri)					
2	5486-4	1/3 Rexhaj Mehmet (Sadri)	Are(2)	5160	1027	4133	Gjakove Jashte Qytet
		1/3 Rexhaj Murat (Sadri)					
		1/3 Rexhaj Islam (Sadri)					
3	5494-4	1/1 Puka Salih (Tahir)	Are(3)	6006	2488	3518	Gjakove Jashte Qytet
4	5494-6	1/1 Puka Salih (Tahir)	Kullose (3)	2694	560	2134	Gjakove Jashte Qytet
5	5495-2	1/1 Puka Salih (Tahir)	Kullose (3)	1480	738	742	Gjakove Jashte Qytet
6	5494-1	1/1 Feraj Ajmana (Mehmet)	Are(4)	11717	47	11670	Gjakove Jashte Qytet
7	5486-3	1/1 Feraj Ajmana (Mehmet)	Are(2)	4816	69	4747	Gjakove Jashte Qytet
8	5531-12	19/60 Gjokaj Gjon (Zef)	Are(4)	6320	770	5550	Gjakove Jashte Qytet
		20/60 Doli Lulzim (Rexhep)					
		1/60 Doli Ganimete (Rexhep)					
		20/60 Doli Gëzim (Rexhep)					
9	5496-0	2/24 Xerxa Shpend (Dervish)	Rruge, Shtëpi-ndertese	990	131	859	Gjakove Jashte Qytet
		2/24 Xerxa Afrim (Dervish)					
		2/24 Xerxa Letafete (Bajram)					
		12/24 Kepuska Rexhep (Isuf)					
		3/24 Xerxa Hysen (Xheladin)					
		3/24 Xerxa Muhamet (Xheladin)					